

ORGANIZATAT NACIONALISTE NË KOSOVË GJATË VITEVE
1941-1947

TEMA PËR TITULLIN MASTER I HISTORISË NË DEPARTAMENTIN E
HISTORISË

NGA
GENTRIT ISUFI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË

DHJETOR, 2022

Në punimin e masterit, “Organizatrat nacionaliste në Kosovë gjatë viteve 1941-1947”, është trajtuar mënyra dhe kondita e formimit të organizatave nacionaliste shqiptare në Kosovë duke ndjekur rendin kronologjik, janë sqaruar motivet e formimit dhe veprimet e tyre organizative si dhe struktura vertikale, statutet mbi të cilat kanë vepruar, si dhe bashkëpunimet e tyre me organizatat e tjera si dhe me Qeverinë Kombëtare në Tiranë, bashkëpunim me gjermanët, italianët dhe anglezët. Organizimet politike-ushtarake kanë një rëndësi kruciale në periudhën e veprimit të këtyre organizatave.

Gjatë punimit të masterit, duke u bazuar në kriteret e metodologjisë së historisë dhe metodave hulumtuse bashkëkohore, është bërë klasifikimi i burimeve, komperacioni i tyre si dhe analiza e materialeve të ndryshme të cilat kanë një relacion direkt me temën. Duke qenë se kjo temë gjatë viteve të komunizmit në Kosovë dhe në Shqipëri ka qenë e anatemuar, dhe shumë herë në trajtimin e këtyre organizatave është shkruar me terma pezhorativ, ka qenë një sfidë për klasifikimin dhe interpretimin e burimeve të ndryshme.

Mes dy luftërave botërore për shqiptarët e Kosovës ishte një periudhë aspak e lehtë, Jugosllavi monarkiste e cila nën dirigjimin e Serbisë ishte e vendosur për të vazhduar projektin e saj hegjemonist, për shpërnguljen dhe deportimin e shqiptarëve, minimizimi i të drejtave politike deri tek vrasjet e deputetëve shqiptar, bënë që tek popullsia shqiptare të shkaktohet një indinjat e thellë. Pikërisht ishte fillimi i Luftës së Dytë Botërore, që ndaloi këtë reprezalë të pushtetit serb ndaj popullsisë shqiptare, elita politike shqiptare do ta shfrytëzonte pushtimin e Jugosllavisë nga Gjermania naziste, për të emancipuar popullin shqiptar që ta shfrytëzonte këtë hapsirë lirie që ishte tani më, për tu organizuar kundër ekspanisioneve të reja të cilat mund t'i ndërrmerre Serbia, për këtë nacionalistet shqiptar në numër të madh kishin filluar që të ushtronin profesionin e mësimdhënësit, në shkollat që po hapeshin në 1941 në Kosovë. Në Kapitullin e parë do të trajtohet rezisten shqiptare ndaj pushtimit të Kosovës nga Gjermania Naziste dhe Italia Fashiste, jepen argumente pse shqiptarët nuk rezistuan ndaj këtij pushtimi të ri, pastaj kapitulli vazhdon me ndarjen gjeografike të Kosovës në mes të Gjermanisë, Italisë dhe Bullgarisë.

Në Kapitullin e Dytë trajtohet roli i patriotëve kosovar që para vitit 1941 ishin në emigracion, të cilët me ardhjen e tyre në Kosovë, gjegjësisht në Mitrovicë, do të organizonin Lidhjen Popullore Shqiptare, organizatë që do udhëhiqte politikën kombëtare në Zonën gjermane të Kosovës, duke u përpjekur që të unifikonte territoret shqiptare. Në programin e Lidhjes Popullore Shqiptare, në rend të parë ishte bashkimi i të gjitha trojeve etnike shqiptare në një shtet të vetëm në të cilin mund të realizohej kultura dhe arsimit kombëtar.

Ndër organizimet që do të trajtohet në këtë punim masteri është Lëvizja e Kryezive, e cila për dallim nga organizimet tjera nacionaliste, kjo kishte mbështetjen e anglezve, dhe në një fazë të caktuar kishte bashkëpunuar dhe me akter komunist, kjo lëvizje dhe pse nuk kishte armiqësi ndaj organizatave komuniste, këto të fundit në fund të luftës do ta përndigjnin dhe do të shkatrronin. Fillimi i rezistencës së tyre është që nga prilli i vitit 1941, mirëpo intesifikimi i Lëvizjes së tyre do të jetë pas kapitullimit të Italisë, kur nga internimi kthehet Gani Kryeziu, i cili ishte figura kyçe e kësaj Lëvizje, pikërisht kjo temë do të shtjellohet në kapitullin e tretë.

Pjesa më e madhe e anëtarëve të Lidhjes Popullore Shqiptare pas kapitullimit të Italisë fashiste si dhe ndryshimit që solli në skenën gjeopolitike ndërkombëtare, do të formonin Lidhjen e Dytë të Prizrenit, organizatë më e mirëstrukturuar dhe më e suksesshme politiko-ushtarake e nacionaliste gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndërsa veprimtaria e saj kalonte kufijtë e Kosovës, në punim duke u bazuar në lëndë arkivore janë siguruar dokumente për mbarëvajtjen e Kuvendeve si dhe statute që do të nxirreshin, strukturën politike dhe ushtarake, luftimet kundër çetnikëve dhe komunistëve.

Në kapitullin e Pestë do të trajtohet gjendja e rëndë që u krijua në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, bëri që aty të marrë hov rezistenca kundër shtypjes dhe ripushtimit jugosllav, i cili do të shoqërohet me gjenocid, që edhe pse nën parullën e vllazni-bashkimit pushteti i ri nuk kishte dallim me Jugosllavinë monarkiste sa i përket raportit me shqiptarët. Duke parë gjendjen në terren e cila ishte krejt ndryshe nga ajo se çfarë kishin premtuar partitë komuniste jugosllave dhe shqiptare, nacionalistët shqiptar do të bashkoheshin në një organizatë politiko-ushtarake, që do të kishte për qëllim çlirimin e Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë. Për organizimin e qëndresës popullore dhe për përpunimin e programit e të kërkesë së popullit shqiptar në këto treva u formuan dhe u riaktivizuan grupe dhe organizata politike që ishin pjesë përbërëse e Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare.